

Data 21 /09/2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Lënde Drusore”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Lëndë druri

VLERA E FONDIT LIMIT:

35 833 333 (tridhjetë e pesë milion e teteqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre)
lekëpa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore lëshuar nga Administrata Tatimore të 3 viteve të fundit 2019, 2020, 2021, ku vlera të mos jetë më e vogël se 30% e fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten objekt prokurimi.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë sepse ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të vitit 2019, 2020 dhe 2021 te leshuara nga administrata tatimore, të konfirmuara nga Administrata Tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.

Kandidatët/Operatorët Ekonomikë Ofertues, të cilët janë në kushtet e nenit 41, gërma c, të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009, duhet të paraqesin në procedurën e prokurimit publike dhe akt ekspertizën e kryer nga Eksperti Kontabël I autorizuar, për të tre vitet e kërkuara, 2019, 2020, 2021.

Ku te paketn ne dy bilance te njepasnjeshme , nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2022 sipas afateve të

maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Enti /Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur ne procedure e prokurimit.Ne rast ininformacioni te pasakte do te veprohet conform parashikimeve te ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “PërSistemin e TaksaveVendore” I ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurattatimore” I ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” indryshuar, sidhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” indryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/Enti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet taimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën,

2.3.2. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin e kontratës. Numri i punonjësve të siguruar, duhet të jetë 15 punonjës, për periudhën 6 muajt e fundit. Lidhur me këtë pikë, kandidati/operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore (Administrata Tatimore), në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për çdo muaj, sipas legjislacionit në fuqi, për të gjithë periudhën e kërkuar. Ky kriter plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, (Në fazën e ofertimit plotësohet formulari përkatës, dokumentacioni paraqitet pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.3. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik, Listëpagesat përkatëse E/Sig-25, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën 6 muajt e fundit, sipas legjislacionit në fuqi. Ky kriter plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, (Në fazën e ofertimit plotësohet formulari përkatës, dokumentacioni paraqitet pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.4 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme, për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit, si më poshtë:

- 4 kamion me peshe 7.5 deri ne 18 ton
- 1 kamion me peshe 7.5 deri ne 18 ton me vinc

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë dhe të regjistruar në Shqipëri, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - dhe fotot përkatëse; Ndërsa, përmjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë noteriale.

Ky kriter plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, (Në fazën e ofertimit plotësohet formulari përkatës, dokumentacioni paraqitet pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne nenin 77 , të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 40 pika 5/ç të VKM nr.285 ,datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor kerkon mjetet dhe pajisjet teknike nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion .

2.3.5.Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë I pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit public certifikatat përkatëse të vlefshmetë ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëritë akredituara në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefsh me datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:

ISO 9001:2015 certifikatën e menaxhimit të cilësisë së punimeve; ose ekuivalente.

Çertifikata e mësipërme duhet të jete e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor per te vertetuar se mallrat objekt prokurimi , i plotesojne kerkesat e cilesise , mund tu kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vlersimit te konformitetit, i akredituar nga organizim kombetar ose organizma nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.